

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT: OBJEKTI: “Punime ndërtimore dhe infrastrukture në varrezat publike Sharrë, Tufinë Kashar, Shëngjergj, Bërzhidë, Pezë (4 Lote)”**

**Loti 1: “Studim projektim “Rrethim me mur betoni dhe kangjella në sektorin Tufinë” me fond limit 479,751.91 lekë (katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një pikë nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.**

**Loti 2: “Studim projektim "Sistemim dhe asfaltim rruge parcela 139-146, Sharrë" me fond limit 682,894.68 lekë (gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.**

**Loti 3: “Rrethim me rrjetë teli në varrezat publike katër, Kasharë, Shëngjergj, Bërzhidë, Pezë” me fond limit 564,906.01 lekë (pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e gjashtë pikë zero një) lekë pa TVSH.**

**Loti 4: “Mure mbajtës beton arme në varrezat Kasharë, Tufinë, Sharrë” me fond limit 478,236.55 lekë (katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë pikë pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
79415200-8**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**VLERA E FONDIT LIMIT: “Studim projektim me objekt “Punime ndërtimore dhe infrastrukture në varrezat publike Sharrë, Tufinë Kashar, Shëngjergj, Bërzhidë, Pezë (4 lote)” është 2,205,789.15 (dy milion e dyqind e pesë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë pikë pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.**

**Loti 1: “Studim projektim “Rrethim me mur betoni dhe kangjella në sektorin Tufinë” me fond limit 479,751.91 lekë (katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një pikë nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.**

**Loti 2: “Studim projektim "Sistemim dhe asfaltim rruge parcela 139-146, Sharrë" me fond limit 682,894.68 lekë (gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.**

**Loti 3: “Rrethim me rrjetë teli në varrezat publike katër, Kasharë, Shëngjergj, Bërzhidë, Pezë” me fond limit 564,906.01 lekë (pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e gjashtë pikë zero një) lekë pa TVSH.**

**Loti 4: “Mure mbajtës beton arme në varrezat Kasharë, Tufinë, Sharrë” me fond limit 478,236.55 lekë (katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë pikë pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Shërbimeve Funerale ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

### **LOTI 1: “STUDIM PROJEKTIMI “RRETHIM ME MUR BETONI DHE KANGJELLA NË SEKTORIN TUFINË”**

**Objekti Loti 1 “Studim projektim " Rrethim me mur betoni dhe kangjella në sektorin Tufinë " është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve për vitin 2023. Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2023.**

Vlera e përlloritur e fondit limit për objektin Loti 1 “Studim projektim "Rrethim me mur betoni dhe kangjella në sektorin Tufinë" është 479,751.91 lekë (katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një pikë nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

- a. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 12;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

#### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Referuar pikës 1 të shtojcës 11, kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 12.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, dhe nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021-2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% (vlera 143,925.57 njërqind e dyzet e tre mijë e nëntëqind e njëzet e pesë pikë pesëdhjetë e shtatë lekë) të vlerës së përlloritur të lotit 1/ shumatores së loteve për të cilat konkurron. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur, nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros së kërkuar në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 50 dhe nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në pikën 1, pikën 2, gërma (c) dhe pikën 3 të nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% (1 vlera 143,925.57 njërqind e dyzet e tre mijë e nëntëqind e njëzet e pesë pikë pesëdhjetë e shtatë lekë) të vlerës së përlloritur të lotit 1/ shumatores së loteve për të cilat konkurron. Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto dy vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29 të ligjit nr.8438 date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat", i ndryshuar.

**2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021-2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 shkronja "c" të Ligjit nr.10091, datë 5.3.2009. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 50 dhe 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 54 dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe të nenit 41 shkronja "c" të Ligjit nr.10091, datë 5.3.2009 "Për auditimin

ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

**Shënim:** Operatorët ekonomikë ofertues në më shumë se një Lot, duhet të kenë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e pikës 2.2) sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

**3.** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2022, të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022, pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operoret ekonomik te kualifikuar te fazes se pare (lista e shkurtër), duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet te paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % (vlera 143,925.57 njërqind e dyzet e tre mijë e nëntëqind e njëzet e pesë pikë**

*pesëdhjetë e shtatë lekë) të vlerës së fondit të limit Loti 1/ shumatores së loteve për të cilat konkuron.*

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë, vërtetim të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nënin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nënin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nënin e sipërcituar. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi

---

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është 143,925.57 njërqind e dyzet e tre mijë e nëntëqind e njëzet e pesë pikë pesëdhjetë e shtatë) lekë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit limit e lotit 1/ shumatores së loteve për të cilat konkuron. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik për procedurën Shërbim Konsulence dhe i shërben autoritetit kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën e kërkuar, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitetet e duhura për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

**2. Operatorit ekonomik duhet të paraqesë Liçensë profesionale(e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për**

**dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:**

**KAT 2 PROJEKTUES ARKITEKT:**

2/ d- Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe te gjelberta, lulishte e parqe;

**KAT 3 PROJEKTUES KONSTRUKTOR:**

3/c/2. Troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët;

*(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020“Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim-përcaktimi i aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Liçensat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë sipas Detyrës së projektimit.

**3. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik, të përfshirë si drejtues teknik në Liçencën e shoqërisë dhe në listëpagesat e muajve Janar - Shkurt 2023 sa më poshtë:**

- 1 (nje) Arkitekt;
- 1(nje) Inxhinier Ndertimi (profili Konstruktor/Strukturist/ Infrastruktura transporti);

Për secilin pjestar të stafit kryesor të mësipërm duhet të paraqesë, Kontratë pune e vlefshme, diplomë.

*Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.*

*Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

**Shënim:** Sqarohet se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazës së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet e paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Për vendosjen e stafit i është referuar Termave të referencës për objektin pjesë e kësaj procedure (Loti 1), pjesë e sëcilave do të jenë të liçensuar për shërbimet që priten të realizohen.

**Kërkesa për 1(një) inxhinier ndërtimi** (profili Konstruktor/Strukturist/ Infrastruktura transporti) Konsiderohet i nevojshëm për hartimin e projektit të zbatimit dhe relacionit përkatës sipas përcaktimeve në detyrën e projektimit si dhe në mbështeshtje të pikës 1 të nenit 15 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” e ndryshuar, në të cilin është parashikuar dokumentacioni për pajisje me leje ndërtimi.

Punimet për shërbimin e projekteve strukturore kanë një volum të rëndësishëm, pasi projekti i konstruksionit zë peshë relativisht të madhe për realizimin e objektit.

#### **Kërkesa për 1 (një) Arkitekt**

Konsiderohet i nevojshëm pasi duke iu referuar detyrës së projektimit janë përcaktuar detyrat dhe qëllimet për realizimin e këtij projekti, i cili ka të përfshirë hartimin e projektit arkitektonik me detajet përkatëse për realizimin e tij.

Konsiderohet i nevojshëm për hartimin e projektit të zbatimit dhe relacionit përkatës sipas përcaktimeve në detyrën e projektimit si dhe në mbështeshtje të pikës 1 të nenit 15 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” e ndryshuar, në të cilin është parashikuar dokumentacioni për pajisje me leje ndërtimi.

Drejtuesit teknik të kërkuar më sipër kanë peshën kryesore në realizimin e projekteve që kërkohej të realizohen bazuar në termat e referencës së Detyrës së Projektimit

#### **4. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij ose me kontratë bashkëpunimi të vlefshme për inxhinierët dhe ekspertët e mëposhtëm:**

- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Markshajder/Topograf

Që disponon licencë profesionale të vlefshme për “PROJEKTUES GJEODET” me kategorinë:

- 8/a Rilevime inxhinjerie;

-1 (një) Inxhinier Gjeolog/Hidrogeolog/Gjeoteknikë

Që disponon licencë profesionale të vlefshme për “STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK – HIDROGJEOLOGJIK” me kategorinë:

9/d Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët;

- 1 (një) Ekspert Mjedisi të pajisur me Çertifikatë ”Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” të lëshuar nga organet Kompetente sipas ligjeve në fuqi.

Operatori ekonomik për stafin e mësipërm duhet të paraqesë dokumentet:

- Diplomë*
- CV (Preferohet të ketë realizuar projekte ose ekspertiza në fushën përkatëse sipas detyrës së projektimit)*
- Kontratë të vlefshme pune ose bashkëpunimi për periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi*
- Licencë ose Çertifikatë përkatëse të lëshuar nga institucionet e autorizuara me ligj.*
- Deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

***Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.***

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësve.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b dhe 4/d, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Për vendosjen e stafit i është referuar Termave të referencës, natyrës së përgjithshme të shërbimeve që priten të ofrohen. Meqenëse kemi të bëjmë me një objekt me shtrirje të madhe prezenca e stafit të mësipër është gjykuar si e domosdoshme dhe e nevojshme për një shpërndarje dhe efikasitet sa më të madh në realizimin e shërbimeve konkretisht;



### **Kërkesa për 1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Markshajder/Topograf**

Punimet për shërbimin e projektimit topografik do të jenë një zë i rëndësishëm në realizimin e projektit, që parashikohen të ketë dhe volum të konsiderueshëm të punimeve topografike kjo mbështetur në Termat e referencës.

### **Kërkesa për 1 (një) Inxhinier Gjeolog,**

Punimet për studimin dhe vlerësimin gjeologjik do të jenë të pranishëm kryesisht në ndërtimin e objektit (murit rrethues), kjo mbështetur në Termat e referencës.

### **Kërkesa për 1 (një) Ekspert Mjedisi**

Konsiderohet i nevojshëm për hartimin e raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) sipas përcaktimeve në detyrën e projektimit.

Ky kriter është vendosur gjithashtu në përputhje me Ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar në pikën 18 të nenit 6 të cilit është parashikuar se: “*Ekspert i certifikuar i VNM-së*” është personi fizik, i cili pajiset me certifikatën përkatëse nga ministria, për hartimin e raportit të VNM-së, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor dhe pikën 3 të nenit 6 të këtij ligji është parashikuar se: “*Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)*” është procesi që kryhet për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis nga projekte të propozuara publike ose private nëpërmjet:

- a) përgatitjes së raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga zhvilluesi;
- b) kryerjes së konsultimeve sipas kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në kreun III të këtij ligji;
- c) shqyrtimit nga autoriteti kompetent të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të çdo informacioni tjetër shtesë nga zhvilluesi, kur është i nevojshëm, si dhe të çdo informacioni tjetër të rëndësishëm, marrë nëpërmjet procesit të konsultimeve;
- ç) përfundimit të arritur, të arsyetuar nga autoriteti kompetent, për ndikimet e rëndësishme në mjedis të projektit, duke marrë në konsideratë rezultatet e shqyrtimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga autoriteti kompetent dhe kur është e përshtatshme shqyrtimin e vet shtesë;
- d) përfshirjes në vendimin e miratimit të zhvillimit të projektit nga autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit të përfundimeve të arritura të arsyetuara nga autoriteti kompetent.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

***Pikat e licencave apo certifikimeve që nuk trajtohen në V.K.M. nr. 943, datë 28. 12. 2016 duhet të jenë në përputhje me V.K.M. Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (Qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, Ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.***

***5. Operatori ekonomik për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 2 (dy) persona të vërtetuar me dokumentet:***

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën Janar - Shkurt 2023.
- b) Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar - Shkurt 2023.

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësve.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operoret ekonomik te kualifikuar te fazes se pare (lista e shkurtër), duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet te paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: per percaktimin e fuqise punëtore minimale te kerkuar argumentojme se jemi bazuar ne sherbimet e kerkuara sipas Termave te References. *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Numri i mësipërm përkon me stafin që pritet të jetë i angazhuar në këto procedura.*

**6. Operatori ekonomik për realizimin e kontratës, duhet të ketë në pronësi ose me qera pajisjet e mëposhtme:**

- Pajisje topogjedezike GPS                      copë 1 (një)
- Total station                                      copë 1 (një)

Për plotësimin e kësaj kërkesë duhet të paraqitet një dokument i cili vërteton pronësinë ose aktin e marrjes me qera të tyre.

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i mjeteve.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operoret ekonomik te kualifikuar te fazes se pare (lista e shkurtër), duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet te paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kjo pikë nevojitet për të siguruar AK që operatorët disponojnë paisjet teknike të domosdoshme për matjet topografike në terren. Kërkohen të dyja pajisjet për arsye të shtrirjes gjeografike të terrenit dhe relativisht të thyer dhe saktësisë së matjeve që kërkohet.

## **7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatat të përshtatshme ose ekuivalentet e tyre për objektin e prokurimit si më poshtë:**

- a) ISO 9001: 2015, Per menaxhimin e cilesise;
- b) ISO 14001: 2015, Per menaxhimin e cilesise se mjedisit;
- c) ISO 18001-2007, ekuivalente me ISO 45001-2018 (e vlefshme). Sistemi i Menaxhimit për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë;

Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë,

**Shënim:** Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*

Çertifikatat e cilësisë janë bazuar në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

**Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet të referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.**

**Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jete brenda kufijve të vleres minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.**

**Shënim:** Operatorët ekonomikë ofertues në më shumë se një Lot, duhet të kenë kapacitetin teknik (nënpika 1 e pikës 2.3) sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetin teknik për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

**Shënim:** Në mbështetje të nenit 54 pika 9 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar, përcaktohet se: "Në rastin e bashkimit të konsulentëve secili prej tyre duhet të plotësojë kriteret detyruese për kualifikim sipas nenit 76, të LPP-së, ndërkohë kërkesat për kualifikim sipas përcaktimit në nenin 77, të LPP-së, dhe këto rregulla plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi."

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

### **GRAFIKU I LEVRIMIT LOTI 1**

Shërbimi që kërkohet: "Studim projektim "Rrethim me mur betoni dhe kangjella në sektorin Tufinë "

**Afatet e ekzekutimit:** 45 (dzytë e pesë ) ditë nga data e lidhjes së kontratës

### **LOTI 2: "STUDIM PROJEKTIMI "SISTEMIM DHE ASFALTIM RRUGE PARCELA 139-146, SHARRË"**

**Objekti Loti 2: "Studim projektim " Sistemim dhe asfaltim rruge parcela 139-146, Sharrë"** është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve për vitin 2023. Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2023.

Vlera e përlogaritur për objektin "Studim projektim " Sistemim dhe asfaltim rruge parcela 139-146, Sharrë " është 682,894.68 lekë (gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 12;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Referuar pikës 1 të shtojcës 11, kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 12.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021-2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% (204,868.4 dyqind e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë katër lekë) të vlerës së përlllogaritur të lotit 2/ shumatores së loteve për të cilat konkurron. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur, nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros së kërkuar në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 50 dhe nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në pikën 1, pikën 2, gërma (c) dhe pikën 3 të nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% (204,868.4 dyqind e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë katër lekë) të vlerës së përlllogaritur të lotit 2/ shumatores së loteve për të cilat konkurron. Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto dy vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 date 28.12.1998 ”Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

**2.Operatori ekonomik duhet të paraqesë bilancet vjetore, për vitet financiare 2021-2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 shkronja ”c” të Ligjit nr.10091, datë 5.3.2009. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 50 dhe 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 54 dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe të nenit 41 shkronja ”c” të Ligjit nr.10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

**Shënim:** Operatorët ekonomikë ofertues në më shumë se një Lot, duhet të kenë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e pikës 2.2) sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

### **3. Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12.**

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2022, të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022, pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për“Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operoret ekonomik te kualifikuar te fazes se pare (lista e shkurtër), duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet te paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % (204,868.4 dyqind e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë katër lekë) të vlerës së fondit të limit të loti 2/ shumatores së loteve për të cilat konkuron.**

**Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:**

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.**
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.**

**Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nën 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nën 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi

---

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është 204,868.4 (dyqind e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë katër) lekë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit limit e lotit 2/ shumatores së loteve për të cilat konkuron. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik për procedurën Shërbim Konsulence dhe i shërben autoritetit kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën e kërkuar, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitetet e duhura për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

**2. Operatorit ekonomik duhet të paraqesë Liçensë profesionale(e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:**

#### **Kat 6 PROJEKTUES RRUGE – HEKURUDHA**

6/a Projektimi rruge lokale, rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane kryesore

#### **Kat 8 PROJEKTUES GJEODET**

8/a Rilevime inxhinjerike;

#### **Kat 11 PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR**

11/a Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

*(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim-përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Liçensat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

**3. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik, të përfshirë si drejtues teknik në Liçencën e shoqërisë dhe në listëpagesat e muajve Janar - Shkurt 2023 sa më poshtë:**

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Markshajder/Topograf/Gjeomatik



Për secilin pjeshtar të stafit kryesor të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, diplomë.

***Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.***

***Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.***

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësve.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazës së parë (lista e shkurtër), duhet të dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet e paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b dhe 4/d, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Për vendosjen e stafit i është referuar Termave të referencës për objektin pjesë e kësaj procedure (Loti 2), pjesë e sëcilave do të jenë të liçensuar për shërbimet që priten të realizohen.

#### **Kërkesa për 1(një) inxhinier ndërtimi**

Konsiderohet i nevojshëm për hartimin e projektit të zbatimit dhe relacionit përkatës sipas përcaktimeve në detyrën e projektimit si dhe në mbështeshtë të pikës 1 të nenit 15 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” e ndryshuar, në të cilin është parashikuar dokumentacioni për pajisje me leje ndërtimi.

#### **Kërkesa për 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Markshajder/Topograf/Gjeomatik;**

Konsiderohet i nevojshëm për hartimin e projektit të zbatimit pasi parashikohet të ketë volum të konsiderueshëm të punimeve topografike, referuar dhe Termave të referencës.

Drejtuesit teknik të kërkuar më sipër kanë peshën kryesore në realizimin e projekteve që kërkohet të realizohen bazuar në termat e referencës së Detyrës së Projektimit

#### ***4.Operatori ekonomik duhet të disponojë në stafin e tij ose të ketë kontratë bashkëpunimi të vlefshme për inxhinierët dhe ekspertët e mëposhtëm:***

-1 (një) Inxhinier Gjeolog/Hidrogjeolog/Gjeoteknikë

Që disponon licencë profesionale të vlefshme për “STUDIM GJEOLOGO-INXHINIERIK – HIDROGJEOLOGJIK” me kategorinë:

9/d- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët;

-1(një) Inxhinier Hidroteknik

Që disponon licencë profesionale të vlefshme për “PROJEKTUES VEPRRA HIDRAULIKE” me

kategorinë:

5/d- Vepra ujitje - kullimi - impiante vaditëse - diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) - damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino;

- 1(një) Ekspert Mjedisi të pajisur me Çertifikatë "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" të lëshuar nga organet kompetente sipas ligjeve në fuqi.

Operatori ekonomik për stafin e mësipërm duhet të paraqesë dokumentet:

- a. *Diplomë*
- b. *CV (Preferohet të ketë realizuar projekte ose ekspertiza në fushën përkatëse sipas detyrës së projektimit)*
- c. *Kontratë të vlefshme pune ose bashkëpunimi për periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi*
- d. *Licencë ose Çertifikatë përkatëse të lëshuar nga institucionet e autorizuara me ligj.*
- e. *Deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

***Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.***

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësve.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/b dhe 4/d, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Për vendosjen e stafit i është referuar Termave të referencës, natyrës së përgjithshme të shërbimeve që priten të ofrohen. Meqenëse kemi të bëjmë me një objekt me shtrirje të madhe prezencë e stafit të mësipër është gjykuar si e domosdoshme dhe e nevojshme për një shpërndarje dhe efikasitet sa më të madh në realizimin e shërbimeve konkretisht;

#### **Kërkesa për 1 (një) Inxhinier Gjeolog,**

Punimet për studimin dhe vlerësimin gjeologjik do të jenë të pranishëm kryesisht në ndërtimin e objektit, në mbështetje dhe të Termave të referencës.

#### **Kërkesa për 1 (një) Inxhinier Hidroteknik**

Punimet për shërbimin e projektimit hidroteknik do të jenë të pranishme për realizimin e rrjetit të kanalizimeve të ujrave të shiut, në mbështetje dhe të Termave të referencës.

#### **Kërkesa për 1 (një) Ekspert Mjedisi**

Konsiderohet i nevojshëm për hartimin e raportit të Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) sipas përcaktimeve në detyrën e projektimit.

Ky kriter është vendosur gjithashtu në përputhje me Ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar në pikën 18 të nenit 6 të cilit është parashikuar se: “Ekspert i certifikuar i VNM-së” është personi fizik, i cili pajiset me certifikatën përkatëse nga ministria, për hartimin e raportit të VNM-së, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor dhe pikën 3 të nenit 6 të këtij ligji është parashikuar se: “Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)” është procesi që kryhet për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis nga projekte të propozuara publike ose private nëpërmjet:

- a) përgatitjes së raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga zhvilluesi;
- b) kryerjes së konsultimeve sipas kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në kreun III të këtij ligji;
- c) shqyrtimit nga autoriteti kompetent të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të çdo informacioni tjetër shtesë nga zhvilluesi, kur është i nevojshëm, si dhe të çdo informacioni tjetër të rëndësishëm, marrë nëpërmjet procesit të konsultimeve;
- ç) përfundimit të arritur, të arsyetuar nga autoriteti kompetent, për ndikimet e rëndësishme në mjedis të projektit, duke marrë në konsideratë rezultatet e shqyrtimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga autoriteti kompetent dhe kur është e përshtatshme shqyrtimin e vet shtesë;
- d) përfshirjes në vendimin e miratimit të zhvillimit të projektit nga autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit të përfundimeve të arritura të arsyetuara nga autoriteti kompetent.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente

***Pikat e licencave apo certifikimeve që nuk trajtohen në V.K.M. nr. 943, datë 28. 12. 2016 duhet të jenë në përputhje me V.K.M. Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (Qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, Ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.***

***5. Operatori ekonomik për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 2(dy) persona.***

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën Janar - Shkurt 2023,
- b) Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar - Shkurt 2023.

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësve.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojme se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të Referencës. *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Numri i mësipërm përkon me stafin që pritet të jetë i angazhuar në këto procedura.*

**6. Operatori ekonomik për realizimin e kontratës, duhet të ketë në pronësi ose me qera pajisjet e mëposhtme:**

- Pajisje topogjedezike GPS                      copë 1 (një)
- Total station                                      copë 1 (një)

Për plotësimin e kësaj kërkesë duhet të paraqitet një dokument i cili vërteton pronësinë ose aktin e marrjes me qera të tyre.

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i mjeteve.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kjo pikë nevojitet për të siguruar AK që operatorët disponojnë pajisjet teknike të domosdoshme për matjet topografike në terren. Kërkohen të dyja pajisjet për arsye të shtrirjes gjeografike të terrenit dhe relativisht të thyer dhe saktësisë së matjeve që kërkohet.

**7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatat të përshtatshme ose ekuivalentet e tyre për objektin e prokurimit si më poshtë:**

- a) ISO 9001: 2015, Per menaxhimin e cilesise;

- b) ISO 14001: 2015, Per menaxhimin e cilesise se mjedisit;
- c) ISO 18001-2007, ekuivalente me ISO 45001-2018 (e vlefshme). Sistemi i Menaxhimit për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë;

Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Shënim:** Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësiperme janë vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*

*Çertifikatat e cilësisë janë bazuar në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.*

**Operatori ekonomik ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.**

**Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”.**

**Shënim:** Operatorët ekonomikë ofertues në më shumë se një Lot, duhet të kenë kapacitetin teknik (nënpika 1 e pikës 2.3) sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriteve kumulative nuk plotëson kapacitetin teknik për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

**Shënim:** Në mbështetje të nenit 54 pika 9 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar, përcaktohet se: “Në rastin e bashkimit të konsulentëve secili prej tyre duhet të plotësojë kriteret detyruese për kualifikim sipas nenit 76, të LPP-së, ndërkohë kërkesat për kualifikim sipas përcaktimit në nenin 77, të LPP-së, dhe këto rregulla plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi.”

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

### **GRAFIKU I LEVRIMIT LOTI 2**

Shërbimi që kërkohet: "Studim projektim "Sistemim dhe asfaltim rruge parcela 139-146, Sharrë "

**Afatet e ekzekutimit:** 45 (dyzetë e pesë) ditë nga data e lidhjes së kontratës

### **LOTI 3: "STUDIM PROJEKTIM "RRETHIM ME RRJETË TELI NË VARREZAT PUBLIKE KATËR, KASHARË, SHËNGJERGJ, BËRZHIDË, PEZË"**

**Objekti Loti 3:** "Studim projektim "Rrethim me rrjetë teli në varrezat publike katër, Kasharë, Shëngjergj, Bërzhidë, Pezë" është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve për vitin 2023. Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2023.

Vlera e përlogaritur për objektin "Studim projektim " Rrethim me rrjetë teli në varrezat publike katër, Kasharë, Shëngjergj, Bërzhidë, Pezë " është 564,906.01 lekë (pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e gjashtë pikë zero një) lekë pa TVSH.

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 12;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"i ndryshuar.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Referuar pikës 1 të shtojcës 11, kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 12.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, dhe nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**1. Operatori ekonomik duhet të paraqesi vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021-2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% (169,471.8 njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë lekë) të vlerës së përlogaritur të lotit 3/shumatores së loteve për të cilat konkuron. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur, nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros së kërkuar në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 50 dhe nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në pikën 1, pikën 2, gërma (c) dhe pikën 3 të nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% (169,471.8 njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë lekë) të vlerës së përlogaritur të lotit 3 / shumatores së loteve për të cilat konkuron. Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto dy vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat", i ndryshuar, neni 29.

**2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021-2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 shkronja "c" të Ligjit nr.10091, datë 5.3.2009. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 50 dhe 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 54 dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe të nenit 41 shkronja "c" të Ligjit nr.10091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

**Shënim:** Operatorët ekonomikë ofertues në më shumë se një Lot, duhet të kenë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e pikës 2.2) sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra

së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

### **3. Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12.**

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2022, të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022, pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operoret ekonomik te kualifikuar te fazes se pare (lista e shkurtër), duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet te paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % (169,471.8 njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë lekë) të vlerës së fondit të limit të loti 3/ shumatores së loteve për të cilat konkurron.**

***Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:***



- a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën përkatëse, vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*
- b) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është 169,471.8 njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë lekë, jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit limit e lotit 3/shumatores së loteve për të cilat konuron. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik për procedurën Shërbim Konsulence dhe i shërben autoritetit kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën e kërkuar, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitetet e duhura për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

**2.Operatorit ekonomik duhet të paraqesë Liçensë profesionale(e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënie e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:**

### **KAT 3 PROJEKTUES KONSTRUKTOR:**

3/c/2. Troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët;

### **KAT 8 PROJEKTUES GJEODET:**

8/a Rilevime inxhinjrike

*(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim-përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mesiperme janë vendosur në kuader të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këto procedurë.

**3. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik, të përfshirë si drejtues teknik në Liçencën e shoqërisë dhe në listëpagesat e muajve Janar - Shkurt 2023 sa më poshtë:**

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi/ Strukturist
- 1(një) Inxhinier Gjeodet/Markshajder/Topograf/Gjematik

Për secilin pjestar të stafit kryesor të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, diplomë.

***Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.***

***Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.***

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësve.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazës së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet e paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b dhe 4/d, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të përgjithshme të referencës për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen. Drejtuesit teknik të kërkuar më sipër kanë peshën kryesore në realizimin e projekteve që kërkohet të realizohen bazuar në termat e referencës së Detyrës së Projektimit.

#### **Kërkesa për 1(një) inxhinier ndërtimi/strukturist**

Punimet për shërbimin e projekteve strukturore kanë një volum të rëndësishëm, pasi kryesisht parashikohet të kemi realizim të objekteve me shkallë të ndryshme vështirësie të cilat kërkojnë gjykim dhe punime të specializuara në fushën e projektimit strukturor.

Punimet për shërbimet e projektit në infrastrukturë gjithashtu parashikohet të jenë pjesë e projekteve që do të realizohen me këtë procedurë.

Konsiderohet i nevojshëm për hartimin e projektit të zbatimit dhe relacionit përkatës sipas përcaktimeve në detyrën e projektimit si dhe në mbështetje të pikës 1 të nenit 15 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” e ndryshuar, në të cilin është parashikuar dokumentacioni për pajisje me leje ndërtimi.

#### **Kërkesa për 1 (një) Inxhinier Gjeodet/topograf**

Konsiderohet i nevojshëm për hartimin e projektit të zbatimit pasi parashikohet të ketë volum të konsiderueshëm të punimeve topografike, referuar dhe Termave të referencës.

Drejtuesit teknik të kërkuar më sipër kanë peshën kryesore në realizimin e projekteve që kërkohet të realizohen bazuar në termat e referencës së Detyrës së Projektimit.

#### **4.Operatori ekonomik duhet të disponojë në stafin e tij ose të ketë kontratë bashkëpunimi të vlefshme për inxhinierët dhe ekspertët e mëposhtëm:**

- 1 (një) Inxhinier Gjeolog/Hidrogjeolog/Gjeoteknikë,

Që disponon licencë profesionale të vlefshme për “STUDIM GJEOLOGO-INXHINIERIK – HIDROGJEOLOGJIK” me kategoritë:

9/d Studim/Vlerësim gjeollogo inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët;

- 1 (një) Ekspert Mjedisi të pajisur me Çertifikatë "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" të lëshuar nga organet kompetente sipas ligjeve në fuqi.

Operatori ekonomik për stafin e mësipërm duhet të paraqesë dokumentet:

- a) *Diplomë*
- b) *CV (Preferohet të ketë realizuar projekte ose ekspertiza në fushën përkatëse sipas detyrës së projektimit)*
- c) *Kontratë të vlefshme pune ose bashkëpunimi*
- d) *Licencë dhe Çertifikatë përkatëse të lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj.*
- e) *Deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësve.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operoret ekonomik të kualifikuar të fazës së parë (lista e shkurtër), duhet të dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet e paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ b dhe 4/d, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Per vendosjen e stafit i është referuar Termave të referencës, natyres se pergjithshme te sherbimeve qe priten te ofrohen. Meqenese kemi te bejem me kampuse universitare prezenca e stafit te mesiper eshte gjykuar si e domosdoshme dhe e nevojshme per nje shperndarje dhe efikasitet sa me te madh ne realizimin e sherbimeve konkretisht;

### **Kërkesa për 1 (një) Inxhinier Gjeolog**

Është i nevojshëm për studimin dhe vlerësimin gjeologjik që do të jenë të pranishme kryesisht në ndërtimin e objekteve të reja.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjisllacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

### **Kërkesa për 1 (një) Ekspert Mjedisi**

Konsiderohet i nevojshëm për hartimin e raportit të Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) sipas përcaktimeve në detyrën e projektimit.

Ky kriter është vendosur gjithashtu në përputhje me Ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar në pikën 18 të nenit 6 të të cilit është parashikuar se: "Ekspert i certifikuar i VNM-së" është personi fizik, i cili pajiset me certifikatën përkatëse nga ministria, për hartimin e raportit të VNM-së, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor dhe pikën 3 të nenit 6 të këtij ligji është parashikuar se: "Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)" është

*procesi që kryhet për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis nga projekte të propozuara publike ose private nëpërmjet:*

- a) përgatitjes së raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga zhvilluesi;*
- b) kryerjes së konsultimeve sipas kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në kreun III të këtij ligji;*
- c) shqyrtimit nga autoriteti kompetent të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të çdo informacioni tjetër shtesë nga zhvilluesi, kur është i nevojshëm, si dhe të çdo informacioni tjetër të rëndësishëm, marrë nëpërmjet procesit të konsultimeve;*
- ç) përfundimit të arritur, të arsyetuar nga autoriteti kompetent, për ndikimet e rëndësishme në mjedis të projektit, duke marrë në konsideratë rezultatet e shqyrtimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga autoriteti kompetent dhe kur është e përshtatshme shqyrtimin e vet shtesë;*
- d) përfshirjes në vendimin e miratimit të zhvillimit të projektit nga autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit të përfundimeve të arritura të arsyetuara nga autoriteti kompetent.”*

***Pikat e licencave apo çertifikimeve që nuk trajtohen në V.K.M. nr. 943, datë 28. 12. 2016 duhet të jenë në përputhje me V.K.M. Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (Qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, Ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, V.K.M. Nr. 407 date 19.06.2019 “Për miratimin e procedurës, te kategorive, kushteve, kërkesave te kualifikimit dhe te eksperiencës profesionale për personin, te cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik” dhe akteve nënligjore në fuqi.***

